



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**VENDIM**

Nr.311, datë 21.11.2022

**PËR**

**“MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR VLERËSIMIN ETIK DHE  
PROFESIONAL TË PROKURORËVE TË KOMANDUAR NË KËSHILLIN E  
LARTË TË PROKURORISË””**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, i Kushtetutës, nenet 159, 189, 190, pika 3 dhe 4 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ligjin Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe me propozimin e grupit të punës ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.129, datë 14.09.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë””, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më 21.11.2022.

**KRYETAR**

**Alfred Balla**

